



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 26/11/2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26/11/2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik N.N.P."KADOLLI" SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: Ndërtimi i tre shtatoreve, Xhavit Kozhani, Haradin Bajrami, Ruzhdi Shabani dhe ndërtimi i pllakes perkujtimore në Sllovi me Nr. të Prok: 613 020 101 413 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik N.N.P."KADOLLI" SHPK të dt. 26/11/2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i tre shtatoreve, Xhavit Kozhani, Haradin Bajrami, Ruzhdi Shabani dhe ndërtimi i pllakes perkujtimore në Sllovi" me Nr. të Prok: 613 020 101 413 nxjerr: *Vendimit për shpërblim me kontratë* të AK –së, të datës 26/11/2020 të publikuar në Platformën elektronike e-prokurimi .

1. *Mbetet në fuqi* Vendimi i AK për për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 20/11/2020;
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *[te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit]*
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik N.N.P."KADOLLI"SHPK të dt. 26/11/2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi i tre shtatoreve, Xhavit Kozhani, Haradin Bajrami, Ruzhdi Shabani dhe ndërtimi i pllakes perkujtimore në Sllovi" me Nr. të Prok: 613 020 101 413 Autoriteti Kontraktues, me datë 26/11/2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Kërkesa e juaj për rishqyrtim të Autoriteti Kontraktues ka **arrit jashtë afatit të paraparë** me Ligjin për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 neni 108 pika 3.2. sepse Vendimi i Autoritetit Kontraktues për shpërbllim me kontratë tenderuesve që i ka shpallur të suksesshëm është i datës 20/11/2020, ndërsa Kërkesa për Rishqyrtim është pranuar me datë 26/11/2020, që dmth është bere ditën e 6 dhe është jashtë afatshme

Poashtu sqarim për juve si OE kete kerkese ndoshta keni menduar ta niseni për Komunen e Shtimes dhe e keni drejtuar në Komunen e Lipjanit sepse e gjithë kerkesa me të gjitha informatat është për Komune e Shtimes

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

për Adem Duriqi


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit